



RINDËRTIMI I KADASTRIT

“ Administrimi i mirë i tokës është një prej shumë parakushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, zhvillim i cili ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

fq.01

”

- ✓ Siguria e pronës
- ✓ Rritja e vlerës së pronës
- ✓ Përcaktimi i kufirit të parcelës
- ✓ Matja e objektit për legalizim
- ✓ Trashëgimi e qartë dhe pa konflikte
- ✓ Lehtësi në menaxhimin e pronës

Reformat ligjore si parapërgatitje në funksion të Rindërtimit të Kadastrit

Ligji për Kadastër të Pronës Paluajtshme adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e kadastrës përfshi organizimin institucional të kadastrës në Republikën e Kosovës, përmbajtjen e kadastrit, matjet kadastrale, regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe të drejtave pronësore mbi ato prona në kadastër, Rindërtimin e Kadastrit, etj.

fq.08



Fushata e Informimit publik

Administrimi i mirë i tokës është një prej shumë parakushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, zhvillim i cili ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

fq.14



Aktivitete të tjera në këtë 6 mujor të 2025

fq. 19

Nënshkrimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit për Sistemin e Adresave në Komunat në Veri

fq. 21

Prodhimi dhe instalimi i tabelave me emra të adresave dhe numrave të hyrjeve të objekteve

fq. 24

Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare

fq. 27

Monitorimi i ZKK-ve dhe Gjeodetëve të licencuar

fq. 29

Janar - Qershor 2025
Prishtinë

RINDËRTIMI I KADASTRIT

Administrimi i mirë i tokës është një prej shumë parakushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, zhvillim i cili ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, faktor kyç është kadastrin, që si rol ka paraqitjen grafike të parcelave kadastrale dhe të drejtave pronësore mbi to. Megjithatë, shpeshherë ndodh që gjendja faktike në terren nuk pasqyrohet në kadastër për shkak të një sërë faktorësh.

Harmonizimi i gjendjes faktike në terren me të dhënat në kadastër kërkon ndërmarrjen e veprimeve shtesë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) dhe Zyra Kadastrale Komunale (ZKK), pasi që mirëmbajtja e rregullt e të dhënave nuk mjafton për të siguruar përputhshmëri afatgjate. Këto veprime nënkuptojnë projekte konkrete siç është Rindërtimi i Kadastrit, me anë të së

cilit azhurnohen të dhënat mbi njësitet kadastrale dhe të drejtat pronësore mbi to, përfshirë këtu matjet/rilevimin e njësive, ndarjet, bashkimet, korrigjimet, si dhe bartja e të drejtave pronësore, duke siguruar kështu një pasqyrim të saktë dhe të përditësuar të gjendjes faktike në terren.

Ky harmonizim ndër vite nuk është arritur për shkak të disa arsyeve, nga të cilat më të rëndësishmet janë:

- Mosmirëmbajtja e rregullt e të dhënave,
- Mosparaqitja e kërkesave për ndryshimin e kufijve të parcelave,
- Transaksionet joformale të pronësisë, dhe
- Vjedhja e dokumentacionit kadastral nga Serbia.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

Rindërtimi i kadastrit

Rindërtimi i Kadastrit në Kosovë është proces i përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave mbi pronësinë dhe njësitë kadastrale, me qëllim të sigurimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme për pronat në Kosovë.

PËRFITIMET

- ☒ Siguria e pronës
- ☒ Rritja e vlerës së pronës
- ☒ Përcaktimi i kufirit të parcelës
- ☒ Matja e objektit për legalizim
- ☒ Trashëgimi e qartë dhe pa konflikte
- ☒ Lehtësi në menaxhimin e pronës

Si të bëheni pjesë?

Për informata më të detajuara, ju duhet të merrni pjesë në Informimin Publik, i cili mbahet në zonat përkatëse ku do të bëhet rindërtimi.

A duhet qytetari të paguaj taksë për rindërtim?

Qytetari nuk paguan taksë gjatë rindërtimit për punët gjeodezike dhe shërbimet juridike, pasi këto mbulohen nga Projekti për Rindërtimin e Kadastrit.



Agjencia Kadastrale e Kosovës planifikon të zhvillojë procesin e Rindërtimit të Kadastrit në të gjitha zonat kadastrale ku ekzistojnë mospërputhje, me fokus të veçantë në ato zona ku tregu i pronës është aktiv dhe vlera e pronës është më e lartë. Analiza dhe krahasimi i të dhënave realizohen gjithashtu duke shfrytëzuar ortofotot e reja, të cilat ndihmojnë në identifikimin e trendeve të ndërtimit dhe në kalkulimin e saktë të numrit të objekteve të ndërtuara gjatë viteve.

“RILEVIMI AEROFOTOGRAMETRIK I REPUBLIKES SE KOSOVES”

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është përgjegjëse për realizimin e aero-fotografimit, krijimin e modeleve digjitale të terrenit dhe prodhimin e ortofotovë. Aero-fotografimi i fundit i realizuar në Kosovë daton qysh nga viti 2018. Marrë parasysh ndryshimet e konsiderueshme gjatë periudhës 2018-

2024, është planifikuar realizimi i një projekti të ri për aero-fotografimin, i cili ka pasur për synim pasqyrimin e të gjitha ndryshimeve të ndodhura gjatë këtyre 6 viteve. Në Gjeoportalin shtetëror, tashmë janë publikuar ortofotot për zonat urbane me rezolucion prej 8 cm, duke ofruar një pamje të detajuar dhe të saktë të këtyre zonave, si dhe ato për zonat rurale, me një rezolucion prej 15 cm, për një pasqyrim të plotë të gjithë territorit të Republikës së Kosovës.







Për caktimin e një zone kadastrale për Rindërtimin e Kadastrit (RK), Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) konsultohet me Zyrën Kadastrale Komunale, si dhe me organet përgjegjëse lokale dhe qendrore që kanë interes në këtë proces. AKK-ja merr në konsideratë propozimet e komunave, planet e zhvillimit, planet urbane, interesat e përgjithshme, si dhe kërkesat e institucioneve të ndryshme.

Disa nga kriteret kryesore që duhet të merren parasysh për caktimin e një zone kadastrale për RK janë:

- Niveli i lartë i mospërputhjes midis dy bazave të të dhënave, grafike dhe tekstuale, në Regjistrin e Drejtave të Pronës dhe Pasurisë (RDPP);
- Mospërputhja midis gjendjes në të dhënat e RDPP-së dhe gjendjes faktike në terren, si pasojë e mosazhurnimit të ndryshimeve;
- Realizimi i projekteve të veçanta me interes për institucionet e Kosovës dhe qytetarët;
- Kërkesat e institucioneve lokale (komunave) dhe atyre qendrore për përfshirjen e një zone kadastrale në procesin e RK.

Këtë vit, projekti i Rindërtimit të Kadastrit do të përfshijë 115 zona kadastrale nga 32 komuna të Kosovës, ku planifikohet të rindërtohen mbi 260,000 parcela dhe të përgatiten elaboratet për legalizimin e mbi 100,000 objekteve.

Për analizimin dhe krahasimin e gjendjes së të dhënave gjatë përzgjedhjes së zonave për rindërtim, si dhe për të mbështetur gjithë procesin e Rindërtimit të Kadastrit, është thelbësore të ekzistojë një arkivë e plotë dhe e lehtë për t'u aksesuar e dokumentacionit kadastral. Për këtë arsye, edhe këtë vit ka vazhduar projekti "Skanimi i Dokumenteve Kadastrale Arkivore", që njëherit siguron qasjen efikase në dokumentacionin e nevojshëm.

"SKANIMI I DOKUMENTEVE KADASTRALE ARKIVORE"

Skanimi i dokumenteve arkivore kadastrale është një projekt kapital me rëndësi të veçantë ku të gjitha elaboratet dhe të dhënat arkivore kadastrale skanohen dhe indeksohen në një aplikacion që quhet "Skanimi Masiv", pjesë e sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokës të Kosovës (SIKTK). Qëllimi i këtij projekti është të lehtësojë punën e zyrave kadastrale komunale (ZKK) dhe AKK-së për të rritur cilësinë dhe një qasje më të shpejtë dhe më të saktë në të dhëna për pronarë të caktuar, duke përsheptuar procesin, duke kursyer kohë dhe efikasitet në gjetjen e historikut të rasteve në arkivin dixhital të komunës përkatëse. Kjo ndikon në efikasitetin e punës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme,

transparencën dhe të gjithë pronarët ose aplikantët do të ishin të kënaqur me punën dhe saktësinë e ofruar nga ZKK-ja, si dhe marrjen e të dhënave në një kohë shumë të shpejtë. Kjo gjithashtu ndikon në sigurinë e ruajtjes së dokumenteve arkivore të dixhitalizuara (të skanuara me cilësi të lartë dhe të indeksuara për t'u gjetur lehtësisht në sistem me emrin dhe ID-në e pronarëve). Deri tani janë skanuar dhe indeksuar gjithsej 1.590.411 faqe të dokumentacionit kadastral arkivor në ZKK e Gjilanit, Istogut, Podujevës, Prishtinës, Mitrovicës së Veriut, si dhe në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Projekti është duke vazhduar edhe më tutje dhe përveç dokumentacionit të këtyre komunave pritet të skanohet edhe dokumentacioni kadastral arkivor në Arkivin e Kuvendit të Kosovës dhe ish Entin për Gjeodezi.

Reformat ligjore

si parapërgatitje në funksion të Rindërtimit të Kadastrit

Ligji për Kadastër të Pronës Paluajtshme adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e kadastrës përfshi organizimin institucional të kadastrës në Republikën e Kosovës, përmbajtjen e kadastrit, matjet kadastrale, regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe të drejtave pronësore mbi ato prona në kadastër, Rindërtimin e Kadastrit, etj.



Një nga elementet që ky Ligj trajton dhe rregullon është trajtimi problemeve më të theksuara në të drejtat pronësore që është informaliteti i lartë, ku përfshihen trashëgimit e pa kryera dhe transaksionet e pa zyrtarizuara. Formalizimi i të drejtave pronësore është synim parësor në sektorin e të drejtave pronësore pasi që të drejtat pronësore të pa formalizuara janë jashtë qarkullimit juridik, e cila do të realizohet me fuqizimin e rolit të komisionit për Rindërtimin e Kadastrit.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
MIRATON LIGJIN PËR
KADASTËR TË PRONËS SË
PALUAJTSHME

- ✓ Unifikim i legjislacionit nga fusha e kadastrit.
- ✓ Organizim vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
- ✓ Fuqizimi i rolit të komisionit për Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale.
- ✓ Qasje më e lehtë e institucioneve dhe qytetarëve në informacione kadastrale.



Me reformat e reja është ndryshuar edhe rrjedha ose procedura e realizimit të projektit duke krijuar bazën ligjore për krijimin e Komisioneve dhe Nënkomisioneve të cilat do të trajtojnë kërkesat që dalin nga RK.

Pas aprovimit të Ligjit për kadastrë të pronës së paluajtshme dhe 11 Udhëzime administrative të cilat mbështesin implementimin e këtij Ligji, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka përgatitur edhe Udhëzuesin e punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës). Ky udhëzues i punës është përgatitur për të krijuar standard unik për të gjitha procedurat e matjeve, krijimit, ndryshimit, regjistrimit dhe publikimit të të dhënave të njësive kadastrale, poashtu për të ofruar udhëzime konkrete AKK-së, ZKK-ve, gjeodetëve/kompanive gjeodete, operatorëve ekonomik etj., gjatë regjistrimeve sporadike dhe sistematike të ndryshimeve të njësive kadastrale në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (RDPP).

Udhëzuesi i punës 01/2024 për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale

Njëherit, me qëllim të garantimit të një procesi efikas dhe të suksesshëm në realizimin e projektit të Rindërtimit të Kadastrit, ka hyrë në fuqi edhe "Udhëzuesi i Punës nr. 01/2025 për Rindërtimin e Kadastrit".



Udhëzuesi i Punës nr. 01/2025 për Rindërtimin e Kadastrit

lehtëson zbatimin e projektit për të gjithë aktetë përfshirë ekspertët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Zyrtave Kadastrale Komunale (ZKK), operatorët ekonomikë dhe profesitonistët e tjerë në këtë fushë, rrjedhimisht në këtë trajektore të procesit, përfshihen planifikimi, informimi publik, fushata e matjeve, përpunimi i të dhënave, kontrolli i cilësisë dhe finalizimi i regjistrimeve kadastrale.



Të gjitha këto ndryshime kanë nxjerrë në pah nevojën që këtë vit projekti të ketë një kohëzgjatje të mjaftueshme për realizimin sa më të plotë dhe cilësor. Si rrjedhojë, është shfaqur edhe nevoja për zgjatjen e afatit për përmbylljen e projektit të Bankës Botërore – REGIP.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

 THE WORLD BANK



Vazhdohet projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore (REGIP).

Në kuadër të një bashkëpunimi të shkëlqyer dhe rezultateve konkrete të arritura, përfshirë këtu finalizimin e 11 projekteve, tashmë (AKK), ka marrë dritën e gjelbër për vazhdimin e mëtutjeshëm të projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore (REGIP).

Ky hap shënon fillimin e një viti me ambicie të qarta për realizimin e projekteve kapitale dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit në vendin tonë. Zgjatja e afatit të implementimit të projektit ka rëndësi të veçantë për realizimin e aktiviteteve kyçe të projektit, me fokus në aktivitetet që janë pjesë e planit zhvillimor kombëtar.

Si pjesë e rëndësishme e planit të paraparë për këtë vit, është edhe modernizimi dhe Rindërtimi i Kadastrit në 115 zona kadastrale, projekt ky që tashmë veçse ka nisur. Implementimi i projekteve kapitale dhe realizimi i objektivave të (AKK)-së, do të vazhdojë që të sjelli rezultate të prekshme për qytetarët tanë, njashtu rezultate konkrete në modernizimin e kadastrit, përkitazi digjitalizimin e shërbimeve.

Procesi i Rindërtimit Kadastral (RK) përfshin një sërë veprimesh dhe aktiviteteve të ndërlidhura, të cilat ndahen në disa faza kryesore të projektit:

- Faza përgatitore, para dhe pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE);
- Fushata e informimit publik;
- Identifikimi i trashëgimive të papërfunduara dhe transaksioneve joformale, mbledhja e të dhënave, dokumenteve, provave dhe dëshmime;

- Realizimi i fushatës së matjeve në terren;
- Përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e vendimeve përkatëse;
- Organizimi i shikimit publik;
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave gjatë dhe pas fazës së shikimit publik;
- Shpallja e zonës kadastrale (ose pjesës së saj) të rindërtuar;
- Futja dhe zyrtarizimi i të dhënave në sistemin zyrtar;
- Dorëzimi i të dhënave përfundimtare dhe përmbyllja e projektit RK.



Realizimi i këtyre fazave kryesore bëhet përmes realizimit të objektivave të secilës fazë të projektit. Për secilën fazë bëhet kontrolli i kualitetit nga AKK apo OE i kontraktuar për kontrollë të kualitetit.

NËNSHKRIMI I KONTRATËS ME

OE

PËR

KONTROLLIN E KUALITETIT

Kontrata për këtë projekt është nënshkruar
me dt. 24.06.2025 dhe pritet që të
kontrolloj të gjitha fazat e realizimit të projektit
të Rindërtimit të Kadastrit.

Fushata e Informimit publik

Me qëllim të informimit sa më të saktë, të drejtë dhe që projekti i RK “të arrijë” tek të gjithë banorët e zonës kadastrale ku ai zhvillohet, si fazë e RK është paraparë edhe fushata e informimit publik. Në kuadër të informimi publik, zhvillohen takime me banorët e secilës ZK të përfshirë në RK apo pjesë të saj, për të shpjeguar qëllimin e RK, procedurat e posaçme që aplikohen gjatë RK, përfitimet, të drejtat dhe obligimet e palëve etj. Procesin e fushatës së informimit publik e udhëheq përfaqësuesi i komisionit për RK, ndërsa operatori ekonomik është përgjegjës për:

Përgatitjen dhe lansimin e “spotit informues” në TV dhe radio lokale për projektin e RK,

Përgatitjen dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve të cilat përmbajnë informata mbi rëndësinë e RK-ut dhe shpjegojnë procesin

Vendosjen e posterëve në pjesët më të dukshme dhe më të frekuentuara të zonës kadastrale ku zhvillohet RK si dhe

në objektin e Komunës të cilat përmbajnë informacione me rëndësi për qytetarët,

Takime derë më derë me banorët e zonës etj. Të gjitha materialet që përdoren në fushatën e informimit publik për nga përmbajtja duhet të aprovohen nga nën komisioni/MP për RK. Në gjithë procesin e fushatës së informimit publik realizohet edhe kontrolla e kualitetit nga AKK apo OE të përzgjedhur nga AKK, ku kjo kontroll përfshinë vizita të zonave kadastrale për të vërtetuar vendosjen e posterëve dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve, bashkëbisedime me banorë se a ka arritur informacioni deri tek ata etj.





Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

INFORMIMI PUBLIK
PËR PROJEKTIN E RINDËRTIMIT TË KADASTRIT
NË 115 ZONA KADASTRALE

14 PRILL

Takimi me banorët e zonës kadastrale

Faza e informimit publik kulmon me takimin në mes të palëve të zonës kadastrale dhe akterëve të tjerë të RK-ut si: komisioni për RK, nënkomisionet, përfaqësuesit nga Komuna e ZKK dhe nga operatori ekonomik. Për këtë takim që udhëhiqet nga komisioni për RK apo nën komisioni, paraprakisht nga OE duhet bërë ftesë palëve të ZK-së 7 ditë para fillimit të takimit. Ftesa për pjesëmarrje mund të bëhet përmes: TV dhe radio lokale, posterëve dhe fletëpalosjeve në të cilat specifikohet data, koha, vendi dhe qëllimi i takimit. Operatori ekonomik është i detyruar të sigurojë hapësira të përshtatshme për mbajtjen e takimit. Në rastet kur zona kadastrale ka numër relativisht të madh të palëve, atëherë mund të mbahen 2-3 takime me palët, të ndara sipas lagjeve të zonës kadastrale.

OE bënë prezantimin e planit të punës, orarin e punës, dinamiken e punës, etj, ku më afër i njofton banorët për çdo

ecuri të punës të cilën do ta udhëheq ai. Komuna dhe ZKK do të aktivizoj këshillin e fshatit për informim sa më të mirë dhe krijimin e kontakteve me banorët që nuk janë prezent, do të ofroj të dhënat që disponojnë për zgjidhje sa më të lehtë të qështjeve teknike dhe sigurimin e dokumenteve juridike që ata posedojnë.



Nga takimet e realizuara në të gjitha zonat ku ka filluar projekti ka patur një interesim të jashtëzakonshëm të qytetarëve për tu informuar për projektin dhe benificionet që ata mund të përfitojnë nga realizimi i tij. Mbi 10.000 qytetarë kanë marrë pjesë në këto takime të cilët në mënyrë aktive me pyetje dhe komente janë informuar në detaje për rrjedhën e projektit.





Fushata e matjeve në terren

Pas përfundimit të fazës së informimit publik dhe analizës së të dhënave të cilat OE i ka pranuar nga AKK, OE fillon përgatitjet për fushatën e matjeve. OE duhet të bëjë identifikimin e parcelave të cilat janë në SIKTK-T dhe të njëjtat mungojnë në SIKTK-HK apo të kundërtën, këto parcela duhet të përgatiten

me një shtresë të veçantë në skicat e terrenit. Përveç kufijve të parcelës paraqiten si gjeoinformacion edhe ndërtesat të cilat janë në kuadër të ZK apo bllokut në kuadër të ZK e cila është në proces të RK.

Matja e ndërtesave

Gjatë projektit të RK duhet të matën të gjitha ndërtesat. Matja e ndërtesës bëhet duke matur minimum tri pika të dy brinjëve më të gjata me instrumente gjeodezike, ndërsa brinjët tjera mund edhe të konstruktohen duke matur frontet me distancë matës apo ndonjë metodë tjetër, e cila duhet të ceket. Matja bëhet në shputë të ndërtesës (pa fasadë), poashtu përveç shputës së

ndërtesës duhet të maten edhe të gjitha katet tjera të cilat ndryshojnë nga forma e shputës së themelit të ndërtesës (shputa e bodrumit, shputa e suteranit, shputa e përdheses dhe kateve tjera karakteristike).

Fushata e matjeve ka filluar tashmë në shumicën e zonave të cilat këtë vit janë pjesë e RK-së, matjet po relizohen me instrumente të ndryshme gjeodezike dhe me saktësi të lartë.

Aktivitete të tjera në këtë 6 muaj të 2025

Unifikimi i emërtimeve të Trepçës dhe KEK-ut

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka realizuar një mori aktivitete para fillimit të projektit të RK. Mund të veçojmë aktivitetet në kuadër të ngritjes së kualitetit të të dhënave kadastrale, përfshirë unifikimin e emërtimeve të Trepçës dhe KEK-ut.





Gjithashtu në këtë periudhë janë nënshkruar edhe disa Memorandume Bashkëpunimi me disa institucione si: AKK dhe KEK Sh.A. Nënshkruajnë Memorandum Bashkëpunimi



Memorandum bashkëpunimi Agjencioni Kadastral i Kosovës &
Instituti për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë



**Memorandum bashkëpunimi mes
Agjencisë Kadastrale të Kosovës
dhe Ndërmarrjes Hidroekonomike
“Ibër Lepenc”**

Nënshkrimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit për Sistemin e Adresave në Komunat në Veri

Një hap i rëndësishëm drejt integritetit të plotë dhe funksionalizimit të sistemit të adresave në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës është ndërmarrë këtë vit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Në kuadër të projektit për Kompletimin e Sistemit të Adresave, i cili mbështetet nga Banka Botërore, është planifikuar edhe

implementimi i sistemit të adresave në komunat veriore: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt unifikimit institucional dhe zhvillimit të barabartë për të gjitha komunat e Kosovës me ç'rast u nënshkruan Memorandumet e Bashkëpunimit.

Në këtë frymë të bashkëpunimit të ndërsjellë, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, së bashku me ekipin e tij, ka realizuar vizita zyrtare në të katër komunat veriore, ku janë mbajtur takime të ndara me kryetarët e komunave përkatëse, bashkërisht me ekipet përgjegjëse.

Drejtori Avni Ahmeti vizitoi nga afër ZKK-të në secilën komunë, duke vlerësuar gjendjen aktuale dhe nevojat infrastrukturore, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për punë dhe ofrim të shërbimeve më moderne kadastrale.

Ky angazhim konkret tregon përkushtimin e palodhshëm të AKK-së për të garantuar që çdo qytetar i Republikës së Kosovës, pa dallim, të ketë qasje në shërbimet kadastrale.





Prodhimi dhe instalimi

i tabelave me emra të adresave
dhe numrave të hyrjeve të objekteve

Njëri prej aktiviteteve më të rëndësishme në kuadër të projektit të Adresave ka qenë edhe mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave.

Rëndësi e këtij procesi ka qenë në posedimin e gjendjes më reale sa i përket adresave e më pastaj ka ndikuar edhe në procesin e prodhimit dhe instalimit të tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave si dhe në procesin e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare, në mënyrë që qytetarët të mos mbeten pa adresë zyrtare.

Nga ky projekt janë vendosur plot 341,756 tabela me numra hyrjesh në plot 20 komuna të Republikës së Kosovës.








Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare

Duke pasur parasysh nevojën e institucioneve për të përmirësuar kualitetin e shënimeve që ndërlidhën me adresën dhe lidhjen e qytetarit me adrese të sakta, ka lindur nevoja e vendosjes së bashkëpunimit në mes të ARC, AKK dhe ASHI.

Ofrimi i të dhënave të caktuara nga sistemet burimore elektronike për ndërlidhjen e qytetarit me adrese të sakta është me rëndësi pasi që i mundësohet kërkimi dhe identifikimi i saktë i të dhënave përkatëse përmes parametrave të caktuar.





Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



Adresa zyrtare të regjistruara
deri më **07.05.2025**

Me qëllim të koordinimit sa më të mirë dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, për të realizuar projektin e kompletimit të Sistemit të Adresave, janë nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me institucione të ndryshme si: Komunat, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Agjencinë për Shoqëri të Informacionit.

Nga fillimi i projektit e deri sot janë deklaruar

mbi 250.000 qytetarë

Monitorimi i

ZKK-ve dhe Gjeodetëve të licencuar

Agjencia Kadastrale E Kosovës ka vazhduar me sukses vizitat monitoruese në të gjitha Zyrat Kadastrale Komunale, me qëllim të dorëzimit të raporteve mbi gjetjet e monitorimit të punës dhe aktiviteteve të tyre.

Ekspertët e AKK-së diskutuan në detaje mbi gjetjet e raportit paraprak dhe atij aktual, si dhe mbi aktivitetet e lidhura me procesin e regjistrimit dhe vendosjen e lëndëve përkatëse.

Raporti i përgatitur nga ky monitorim iu

është dorëzohuar drejtorit të ZKK-së dhe kryetarit të komunës përkatëse, së bashku me vërejtjet dhe rekomandimet për secilën prej tyre, si dhe udhëzimet për hapat e mëtejshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, raporti iu është përcjellë gjeodetëve dhe kompanive gjeodezike të licencuara.

Monitorimi mbetet një proces i vazhdueshëm dhe një përgjegjësi e AKK-së për të siguruar cilësinë e shërbimeve kadastrale.





